



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHE

MIRATOHET

KRYETARI

FRAN FRROKAJ

Nr. _____ Prot .

Date ____ . ____ .2018

Lenda : Rregullore e Njesise (Sektorit)Auditimit Bashkia Lezhe

Per organizimin, funksionimin, punesimin ,detyrat dhe kompetencat e Njesise Auditimit te Brendshem sipas tekstit bashkelidhur.

Misioni: Auditimi i Brendshem është një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive dhe i ofron keshillim Kryetarit te Bashkise e projektuar për të shtuar vleren e për të përmirësuar veprimtarinë dhe arritur objektivat,nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike

Mmisioni i njesisë së auditimit të brendshëm, si pjesë e strukturës Bashkisë Lezhe është orientimi i veprimtarisë, në mënyrë të pavarur dhe profesionale, duke dhënë siguri objektive , për përdorimin me efikasitet, efektivitet& ekonomi, menaxhimin e burimeve, përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e riskut,ndjekjen e praktikave më të mira bashkëkohore dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të auditimit.

Objektivat:Vlerësimi i përmbushjes së objektivave të veprimtarisë në Bashkinë Lezhe dhe institucionet e vatrësisë. Vlerësimi i efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm, transaksioneve, si dhe besueshmërinë e sistemeve.

Dhënia dhe ndjekja e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së AB dhe funksionimin e kontrollit te brendshem,përputhje me standartet profesionale.

Detyrat dhe përgjegjësitë e njesisë së auditimit

Në kuadrin e zbatimit të praktikave profesionale duhet te realizojë sipas formateve standarte :

- a) hartimin e planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planet e miratuara;
- b) vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe kontrolleve të brendshme, duke u fokusuar kryesisht në identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike.
- c) përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin ligjor
- d) ruajtjen e aseteve të njësisë publike, besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional të njësisë publike;
- e) dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike
- f) informimin e titullarit të bashkisë
- g) ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna

Baza ligjore

Veprimtaria e njësisë së auditit brendshëm bazohet në ligjin nr. Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, manualin e auditimit të brendshëm, V.K.M nr. 83 datë 03.02.2016 “Për Miratimin e kritereve të krijimit të njësisë së auditit të brendshëm në sektorin publik, dhe rregulloren e njësisë së auditit.

Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

Njësia e auditit të brendshëm është e organizuar si sektor me përbërje një përgjegjës dhe Kater auditues.

Audituesi i Brendshëm është profesionisti i kualifikuar dhe i çertifikuar sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin për auditimin e brendshëm në sektorin publikë

Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtuesit të Njësisë së Auditit.

Drejtuesi i njësisë së auditit të brendshëm është nëpunës civil ka vartësi direkte nga Kryetari i Bashkisë dhe ka detyrat e përgjegjësitë si më poshtë:

- a) hartimin e Kartës së Auditimit, akteve të tjera specifike për fusha të veçanta të auditimit të brendshëm, në zbatim të këtij ligji dhe akteve të tjera në zbatim të tij, si dhe dërgimin e tyre për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditit të brendshëm;
- b) hartimin dhe zbatimin e planit strategjik e vjetor për veprimtarinë e auditit të brendshëm dhe dërgimin për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditit të brendshëm, pas miratimit nga titullari i njësisë publike;
- c) organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së auditimit;
- d) kontrollon cilësinë e angazhimeve të auditimit

- e) Përgatitjen e raportit vjetor, i cili i dërgohet strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.

Detyrat dhe përgjegjësitë e audituesit të brendshëm.

Audituesit e brendshëm janë nëpunës civil në vartësi të drejtuesit të njësisë auditimit dhe kanë detyrat e përgjegjësitë si më poshtë:

- a) të njohin, të respektojnë dhe të ushtrojnë veprimtarinë audituese në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me standardet ndërkombëtare, të pranuar, të auditimit të brendshëm;
- b) të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive dhe me profesionalizëm;
- c) të veprojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Etikës, Kartën e Auditimit dhe rregullat për konfidencialitetin për audituesin e brendshëm;
- d) të kryej auditime në mënyrë të pavarur, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit;
- e) të ruaj konfidencialitetin e të dhënave, fakteve apo rasteve të gjetura gjatë kryerjes së auditimit apo të lidhur me të, si dhe të ruajnë dokumentet për çdo angazhim auditimi të kryer, bazuar në detyrimet, që rrjedhin nga ligjet në fuqi për të drejtat e përdorimit dhe të arkivimit të informacionit zyrtar;
- f) të përditësojë rregullisht njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që t'i përdorin ato me efikasitet dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit;
- g) të japin rekomandime për njësinë e audituar për përmirësimin e veprimtarisë, efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe për masat që duhen ndërmarrë në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare për zhdëmtimin e tyre dhe për të ulur mundësinë e përsëritjes;
- h) të raportojë menjëherë te drejtuesi i njësisë së auditit kur zbulohen parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e audituesve të brendshëm përbëjnë vepër penale.

Kufizimet në veprimtarinë e audituesve të brendshëm

Audituesve të brendshëm u ndalohe:

- a) të përfshihen në kryerjen e funksioneve dhe veprimtarive të tjera të njësisë publike, përveç veprimtarisë audituese;
- b) të mbajnë një mandat politik apo të jenë zgjedhur në funksione drejtuese në strukturat e partive politike;

c) të ushtrojnë çdo veprimtari ose punë tjetër me pagesë apo të kenë përfitime të tjera të natyrave dhe formave, që krijojnë gjendje konflikti interesash me ushtrimin e auditimit, me përjashtim të mësimdhënies dhe publikimit, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil.

Punësimi i audituesve të brendshëm

1. Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga auditues të brendshëm, që punësohen në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil, si dhe në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës në njësitë publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

2. Përveç kushteve të përgjithshme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit që punësohen në njësinë e auditimit të brendshëm, kërkohet plotësimi i kushteve të posaçme si më poshtë:

a) të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet;

b) drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të jetë i certifikuar si “Auditues i brendshëm” dhe të ketë përvojë pune 5 vjet si auditues i brendshëm ose i jashtëm;

c) audituesi i brendshëm duhet të jetë i certifikuar si “Auditues i brendshëm” dhe të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion ose si auditues i brendshëm apo i jashtëm;

ç) punonjësi, që nuk zotëron certifikatën si “Auditues i brendshëm”, por ka përvojë pune 3 vjet në profesion, punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë. Brenda kësaj periudhe ky punonjës duhet t’i nënshtrohet detyrimisht procedurës së certifikimit si “Auditues i brendshëm”. Në rast se brenda këtij afati punonjësi nuk certifikohet si “Auditues i brendshëm”, punonjësit i ndërpriten marrëdhëniet e punës në njësinë e auditimit të brendshëm, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak të këtij ligji.

3. Punonjësit e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm punësohen në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil dhe sipas përcaktimeve të shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 2, të këtij neni.

Ndryshimet ligjore

Çdo ndryshim ligjor, pas miratimit rregullores merret në konsideratë nga administrata e Bashkise

Njohja me rregulloren

Të gjithë nëpunësit dhe punonjësit e Auditit , duhet të njihen individualisht me këtë rregullore dhe nëse e shohin të nevojshme të kërkojnë sqarime dhe interpretime për këtë të fundit,Shërbimeve Mbështetëse .

Tekstin e rregullores duhet të vendosin në dispozicion të të gjithë specialisteve te auditit

Sanksione

Mosrespektimi i rregullores së Auditit te Brendshem , përbën shkak për procedim disiplinor për çdo specialist te auditit që shkel rregulloren, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi (kur nuk përbën vepër penale).

Në sa më sipër, shkelja e rregullores, do të sjellë vendosjen e sanksioneve administrative në bazë të “Kodit të Procedurave Administrative”, “Statusit të nëpunësit civil”, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Mosnjohja e rregullores, nuk e justifikon nëpunësin apo punonjësin nga përgjegjësia dhe sanksionet e lartpërmendura.

Njesia e Auditit te Brendshem

Miratoi: Gjon Marku

Konc:Bib Gjoni

Kopje Nr.3

PERGJESI I SEKTORIT AB.

GJON MARKU